



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 13.05.2019
Dokument parlamentar

RAPORT

**MBI SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
NR.11175, DATË 19.04.2019, “PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË
LIGJIT NR.20/2019, “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.12/2018 PËR
VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË
SË SHETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHJET
E BRENDSHME DHE ANKESAT, NË MINISTRINË E BRENDSHME”**

- *Hyrje*

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjen e datës 06.05.2019, Dekretin e Presidentit të Republikës nr.11175, datë 19.04.2019, “ *Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.20/2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”*”.

Në shqyrtimin të pretendimeve të ngritura në Dekretin e Presidentit për kthimin e ligjit për rishqyrtim, të pranishëm në komision ishin përfaqësues të Presidentit të Republikës dhe Ministrisë së Brendshme .

- *Arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit nr.20/2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”*.

Për të parashtruar arsyet e kthimit për rishqyrtim të Dekretit të Presidentit të Republikës, ishte i pranishëm Z.Bledar Dervishaj, Këshilltari i Çështjeve Ligjore, i cili parashtroi si më poshtë:

Presidenti i Republikës, bazuar në nenin 85, pika 1 dhe 93 të Kushtetutës, ka vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.20/2019“Për disa ndryshime në ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”, duke u mbështetur në këto pretendime (në mënyrë të përmbledhur):

Nga shqyrtimi i ligjit nr.20/2019, konstatohet se ky ligj çënon parimet dhe standartet e vendosura në ligjin ekzistues nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për çështjet e brendshme dhe ankesat, në Ministrinë e Brendshme”. Ndryshimet e miratuara me këtë ligj nuk krijojnë garancitë e nevojshme se një proces kaq i rëndësishëm si vlerësimi kalimtar i punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës, do të realizohet në kohën e duhur, me objektivitet dhe paanshmëri, duke bërë hapa pas në raport me standartet e ligjit në fuqi.

- *Së pari, dispozitat e ligjit nr.20/2019, cenojnë standartet e vendosura dhe pavarësinë e procesit të vlerësimit kalimtar të parashikuar me ligjin nr. 12/2018, si dhe krijojnë terren që ky proces të ketë ndikim politik. Mekanizmi i ri i miratuar në ligjin nr. 20/2019, sipas të cilit punonjësit e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) do të kryejnë vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës në fazën e dytë dhe të tretë, nuk garanton standardin e vendosur për realizimin e këtij procesi me objektivitet, pavarësi dhe paanshmëri.*

Tashmë me kalimin e një periudhe 1-vjeçare nga miratimi i ligjit bazë me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Shqipërisë më datë 28.03.2019, ka miratuar ligjin nr. 20/2019 “Për disa ndryshime në ligjin 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme””.

Nuk rezulton që për këto ndryshime thelbësore në ligj, të jetë kryer ndonjë konsultë me organizatat partnere ndërkombëtare, si misioni PAMECA dhe ICITAP, të cilat kanë qenë aktive dhe kanë dhënë kontributin e tyre në hartimin e ligjit nr.12/2018, aktualisht në fuqi.

Gjithashtu, për këto ndryshime nuk rezulton të jetë kryer as edhe ndonjë seancë konsultimi publik, në kushtet kur ndryshimet që parashikohen janë të një natyre shumë të rëndësishme, pasi prekin drejtpërdrejt strukturat që do të realizojnë procesin e vlerësimit kalimtar, si dhe heqin afatet brenda të cilit do të duhet të përfundojë ky proces për punonjësit subjekt të ligjit. Për më tepër rezulton se ligji nr. 20/2019, është shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Si rezultat i ndryshimeve të bëra me ligjin nr.20/2019, shuhet automatikisht koncepti i krijimit të Trupës së Posaçme të Vlerësimit, strukturë që krijohet pranë Komisionit

Qendror të Vlerësimit dhe Komisionit Vendor të Vlerësimit për vlerësimin e atyre punonjësve, njësave apo strukturave, përbërja apo tipologjia e punës së të cilave, nuk mund të jetë pjesë publike.

Nga shqyrtimi i relacionit të Këshillit të Ministrave dhe raportit të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, i vetmi argument se ku mbështeten këto ndryshime në ligj e që krijojnë një mekanizëm të ri për vlerësimin kalimtar, parashtrohet tek fakti se: “Këto ndryshime propozohen me arsyetimin e uljeve të kostove të procesit dhe zotimin domethënës të burimeve materiale dhe atyre njerëzore, arsye që sollën vonesa në zbatimin e procesit të vlerësimit”.

Sipas relacionit të Qeverisë në momentin e propozimit të ligjit aktual nr.12/2018, procesi i vlerësimit u parashikua se do të kushtonte rreth 300 milionë lekë ose rreth 3 milionë dollarë.

Në shqyrtim të përmbajtjes së dispozitave të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë, në ligjin nr. 20/2019, dhe praktikës parlamentare që ka shoqëruar ligjin bazë nr.12/2018, rezulton se arsyetimi mbi të cilin propozohen këto ndryshime aktuale nuk gjen mbështetje dhe janë pasojë e një vlerësimi jo të thelluar e objektiv.

Konkretisht, ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 20/2019, cënojnë në mënyrë të paargumentuar frymën e ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, si dhe qëllimin në arritjen e objektivave për kryerjen me efektivitet, paanësi dhe sipas standardeve, të procesit të vlerësimit kalimtar të subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, për të cilin ky ligj u miratua.

Në relacionin e Këshillit të Ministrave të muajit shkurt 2018, që shoqëronte propozimin e projektligjit të miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 12/2018, në pjesën e raportit të vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, Qeveria i garantonte Kuvendit, sigurimin e efekteve financiare që sillte ligji, që lidhen me trajtimin financiar të anëtarëve të organeve të vlerësimit kalimtar dhe të sekretariateve teknike përkatëse, por edhe angazhimin e burimeve njerëzore dhe financiare për realizimin e këtij procesi.

Konkretisht, nga përlllogaritjet që kishte kryer Qeveria garantonte mbulimin e shpenzimeve për vitin 2018, që arrinte përafërsisht në vlerën 58 milionë lekë, ndërsa për shpenzimet e parashikuara për komisionet që do të funksionojnë përgjatë vitit 2019 ku vlera e tyre është rreth 478 milionë lekë, do të përfshiheshin në llogaritjet e PBA-së 2019-2021. Ministria e Brendshme dhe institucionet në varësi të saj do t’u garantonin organeve të vlerësimit mjediset e punës dhe logjistikën e nevojshme për të ushtruar detyrën.

Ndërkohë sot, Këshilli i Ministrave, relatton përpara Kuvendit një qasje tërësisht të ndryshme, pa kaluar as edhe një vit nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 12/2018, duke argumentuar se vetë elementi financiar ishte një nga arsyet që solli vonesa në zbatimin e procesit.

Ky argument i Qeverisë dhe i pranuar nga Kuvendi, nuk është bindës dhe nuk mund të pranohet nga Presidenti i Republikës. Mungesa e fondeve nuk përbën argument për të cenuar thelbin e një procesi me interes të lartë publik. Vlerësimi i kostove që paraqet ndërmarrja e një nisme legislative përcaktohet që prej fillimit në çastin kur ndërmerret nisma e ligjit bazë.

Është detyrë e Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë që të garantojnë të gjithë mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e një qëllimi kaq madhor, siç është vlerësimi kalimtar i trupës policore.

Arsyetimi se realizimi i procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme kursen buxhetin e shtetit, duke zvogëluar kostot shtesë, nuk është i mbështetur dhe nuk është aspak në koherencë me interesin e lartë publik që paraqet ky proces, për të garantuar një polici me integritet, profesionale dhe të paanshme.

Këto ndryshime në ligj krijojnë bindjen se qëllimi real i Qeverisë në ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore nuk është zvogëlimin i kostove financiare për realizimin e këtij procesi, por vullneti i shprehur i saj, për ta kontrolluar këtë proces nëpërmjet një strukture vlerësuese në varësi të saj, siç është Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, strukturë aktuale kjo drejtëpëdrejt në varësi të funksionit politik të Ministrit të Brendshëm, pra të Qeverisë. Argumenti i Këshillit të Ministrave se ky mekanizëm i ri garanton të njëjtin standard për të gjithë procesin, pasi punonjësit e SHÇBA-së do t'i nënshtrohen të njëjtit proces në fazë të parë dhe se nuk ndryshojnë kriteret dhe procedurat e vlerësimit, nuk qëndron ligjërish.

Edhe nëse punonjësit e Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave do të kalojnë vlerësimin kalimtar gjatë fazës së parë në cilësinë e subjekteve përparësore, sërish nuk ndryshon fakti ligjor i statusit të kësaj strukture, ku në nenin 8 të ligjit nr. 70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme” ku citohet: “Shërbimi është person juridik publik, strukturë e veçantë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në varësi të drejtëpëdrejtë të ministrit”, duke sjellë kështu dhe ndikimin e drejtëpëdrejtë politik në këtë strukturë.

Në këtë mënyrë, edhe pse sipas ligjit nr. 20/2019, punonjësit e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat përfshihen në rrethin e subjekteve që do të rivlerësohen me prioritet, sërish kalimi me sukses i këtij procesi, nuk ndryshon aspak varësinë e tyre nga një funksion politik si Ministri i Brendshëm. Në këto kushte, dhënia e kompetences për të kryer procesin e vlerësimit kalimtar për fazën e dytë dhe të tretë është një premisë e qartë se procesi mund të ndikohet politikisht.

Realizimi i procesit të vlerësimit kalimtar të forcave policore nga struktura profesionale dhe të pavarura erdhi si nevojë edhe për shkak të faktit që strukturat ekzistuese ku përfshihet dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, nuk kishin funksionuar siç duhet.

Ky ndryshim që pretendohet të realizohet në ligjin e sapomiraturar nr. 20/2019, për t'i dhënë SHÇBA-së, kompetenca për të realizuar vlerësimin kalimtar në polici është një hap

mbrapa dhe cenon haptazi standardet e vendosura nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 12/2018 dhe vet integritetin e procesit në tërësi.

Këto ndryshime të miratuara me ligjin nr. 20/2019, nuk garantojnë të njëjtën pavarësi dhe paanshmëri, që parashikon ligji nr.12/2018, sa kohë që ndryshon struktura që do të realizojë atë, nga një strukturë profesionale me përbërje me profesionistë të jashtëm dhe teknikë, në një strukturë në varësi direkte të një autoriteti politik, si Ministri i Brendshëm.

Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë në çastin e miratimit të ligjit bazë nr. 12/2018, kanë mbajtur qëndrimin se vlerësimi kalimtar i punonjësve të Policisë së Shtetit, është domosdoshmëri në kuadrin edhe të hapave të hedhura nga reforma në drejtësi dhe, specifikisht, të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke marrë në konsideratë rolin e rëndësishëm dhe përfshirjen e Policisë së Shtetit në hetimet ndaj veprave penale.

Pikërisht, referuar këtij qëndrimi, dhe mbështetjes së sistemit të drejtësisë në tërësi, vlerësimi kalimtar i forcave policore përbën një interes të lartë publik dhe për këtë arsye mekanizmat apo strukturat që duhet ta realizojnë këtë proces duhet të jenë sa më larg ndikimit politik, për të bërë të mundur që ato të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar me qëllim që të garantohet integriteti dhe besueshmëria e të gjithë procesit.

Presidenti i Republikës, referuar argumenteve të parashtruar me sipër, vlerëson se ligji nr. 20/2019, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme””, nuk mund të dekretohet me shpallje, por i duhet kthyer Kuvendit për rishqyrtim me qëllim rivlerësimin e qëndrimit ndaj kësaj çështjeje me rëndësi të lartë publike.

- **Së dyti**, ligji nr. 20/2019, eliminon detyrimin ligjor për të përfunduar procesin e vlerësimit kalimtar brenda një afati të caktuar, duke krijuar kështu mundësinë e zgjatjes së tij pa afat dhe një terreni të përshtatshëm për mbajtjen nën presion të vazhduar të forcave policore nëpërmjet forcës ndëshkuese të mekanizmit të vlerësimit kalimtar (vetting-ut) nga struktura e SHÇBA-së.

Në nenin 9, të ligjit nr. 20/2019, parashikohet shfuqizimi i nenit 68 i ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”,

Konkretisht, në këtë dispozitë që shfuqizohet parashikohet shprehimisht: “Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat do të përfundojë brenda një periudhe prej 24 muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Referuar kohës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 12/2018, sipas nenit 68, parashikohej ligjërisht që i gjithë procesi i vlerësimit kalimtar duhet të përfundojë brenda muajit prill 2020.

Në këtë mënyrë, sipas parashikimit të nenit 9 të ligjit nr. 20/2019, eliminohet afati 2-vjeçar për përfundimin e procesit për vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Në relacionin shoqërues të Këshillit të Ministrave dhe raportin e Komisionit për Sigurinë Kombëtare, nuk gjendet aspak e justifikuar, përse po hiqet afati i përgjithshëm ligjor për përfundimin e procesit të vlerësimit kalimtar. Në të dy këto dokumente si Qeveritar, ashtu dhe atij parlamentar, përmendet vetëm fakti se eliminohet afati 2-vjeçar për përfundimin e procesit, sepse procesi në vetvete filloi me gati 9 muaj vonesë dhe nuk mendohet që ky afat 2-vjeçar mund të respektohet.

Ky argument nuk qëndron, pasi në mungesë të mundësisë për ta përmbyllur brenda afateve ligjore tërësisht procesin e vlerësimit kalimtar, Kuvendi mund dhe duhet të kishte vlerësuar faktin se ky afat edhe mund të shtyhej sipas nevojës dhe vonesës së deritanishme, por nuk mundet kurrësesi që afati i parashikuar në ligjin ekzistues, të hiqet fare, pasi kjo është e papranueshme.

Nëse do të bëjmë një analogji të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligjet respektive se ky proces realizohet brenda një afati të caktuar me ligj. Afatet e përcaktuara qartësojnë objektivat, rristrukturojnë përparësitë dhe kanalizojnë dhe orientojnë burimet për përmbushjen e qëllimit, i cili në rastin konkret, është imediat dhe me interes kombëtar.

Paralelisht me realizimin e procesit të vetting-ut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, shteti shqiptar duhet të realizojë edhe vlerësimin kalimtar të forcave policore, pasi ato janë struktura bazë që kryejnë veprimtari gjurmuese, parandaluese dhe hetimore.

Zgjatja e këtij procesi me një afat të papërcaktuar, përveç se nuk përkon me nevojën imediate që ka shteti shqiptar për një Polici Shteti të vetuar dhe që të ketë kaluar procesin e vlerësimit kalimtar (vetting-ut), por nga ana tjetër, krijon gjendje pasigurie të tejzgjatur për çdo punonjës subjekt i ligjit, referuar faktit nëse do ta kalojë apo jo procesin e vetting-ut.

Pikërisht, kjo gjendje pasigurie me afat të papërcaktuar e kombinuar edhe me faktin që struktura që do të duhet ta realizojë procesin e vetting-ut është SHÇBA-ja, një strukturë në varësi direkte të një funksionari politik, ndikon drejtëpërdrejt në rezultatet dhe punën e forcave policore, të cilat nën një situatë të tillë pasigurie dhe tensioni, mund të humbasin vigjilencën, mund të ulin angazhimin e tyre përkundrejt luftës kundër kriminalitetit në vend, ndërkohë që presioni i çfarëdo natyre, ekonomik apo politik, është gjithmonë i pranishëm në shoqërinë tonë. Kjo situatë pasigurie e personelit policor është e pritshme të keqpërdoret së tepërmi në situata të veçanta, sidomos përgjatë proceseve zgjedhore.

Në këtë mënyrë heqja e afatit fundor se kur ky proces vlerësimi kalimtar duhet të përfundojë e përkeqëson situatën në këtë drejtim.

Mospërcaktimi i kohës së mbylljes së procesit të vlerësimit kalimtar (vetting-ut), krijon terren që ky proces të përdoret si një mekanizëm ndëshkimor, apo shantazhues për gjithë strukturën policore, çka mund të sjellë një situatë shqetësuese në këtë strukturë.

Konkretisht, mospërcaktimi i afatit se kur përfundon procesi vetting mund të sjellë:

a) rrezikun e ndikimit dhe presionit të vazhduar ndaj veprimtarisë së përditshme të forcave policore;

b) mund ta zgjasë kohën e qëndrimit brenda forcave policore të individëve që nuk e meritojnë të jenë pjesë e Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës dhe që, për shkak të profilit të tyre, janë lehtësisht të shantazhueshëm;

Nevoja që kohëzgjatja të jetë e arsyeshme dhe me afat të përcaktuar qartë në procese të tilla, si këto të vlerësimit kalimtar (vetting-ut), është arsyetuar edhe nga Komisioni i Venecias gjatë dhënies së komenteve dhe opinioneve në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë. Komisioni i Venecias gjithmonë ka rekomanduar se duhet përcaktuar në mënyrë të arsyeshme dhe të qartë kohëzgjatja e procesit të vetting-ut, pasi ky proces është një masë e jashtëzakonshme me karakter të përkohshëm. Edhe sipas nenit 68, të ligjit nr. 12/2018 që është aktualisht në fuqi, është parashikuar që i gjithë procesi përfundon brenda 24 muajve dhe në këtë mënyrë, gjithëkush e di që brenda këtij afati do të marrë një përgjigje përfundimtare, nëse do të vijojë të jetë pjesë e forcave policore ose jo.

Heqja tërësore e afatit se kur përfundon ky proces, bie në kundërshtim të hapur me interesin publik që ka vetë realizimi i tij, por gjithashtu edhe me respektimin e të drejtave të subjekteve që do t'i nënshtrohen atij.

- ***Baza ligjore e shqyrtimit të Dekretit***

Baza Ligjore mbi të cilën Komisioni për Sigurinë Kombëtare, shqyrton Dekretin e Presidentit është:

- ***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 85 të saj përcakton se:***

Neni 85

- 1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.*
- 2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.*

- ***Rregullorja e Kuvendit, e cila në nenin 86 të saj përcakton se:***

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

- 1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.*
- 2. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimi paraqet*

raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.

• ***Argumentet ligjore kundër dekretit të Presidentit të Republikës***

I pranishëm në Komisionin për Sigurinë Kombëtare, për të diskutuar në lidhje me argumentet e shprehura nga Presidenti i Republikës për kthimin për rishqyrtim të *ligjit nr.20/2019“Për disa ndryshime në ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”*, ishte Ministri i Brendshëm Z.Sandër Lleshaj i cili parashtrroi si më poshtë:

Së pari, ligji, tashmë i miratuar nga Kuvendi, në thelb nuk ka cënuar aspak përmbajtjen e ligjit të mëparshëm dhe përpjekja për të ndryshuar ligjin lidhet vetëm me aspektet teknike, të cilat kanë të bëjnë me afatin e vlefshmërisë së ligjit, për arsye se ligji e mbaron efektshmërinë e tij në muajin mars të vitit të ardhshëm dhe koha në dispozicion për të bërë vettingun e rreth 14 000 punonjësve të policisë është fizikisht e pamundur. Pra, ligji automatikisht del jashtë vlefshmërisë së tij, ndërkohë që deri në muajin mars të vitit të ardhshëm besoj se askush nuk mund të ketë iluzione që procesi mund të mbyllet.

Për sa i përket pretendimit për prekjen e ligjit, në thelb të ligjit parashikohen tri komisione: Komisioni i Jashtëm për në fazën e parë, i cili përbëhet nga 15 komisionerë ose vlerësues dhe 15 vetë staf sekretarie, i cili qëndron nga fillimi deri në fund të procesit. Pra, në fazën e parë, të dytë dhe të tretë, thelbi i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, të cilët janë njerëz të jashtëm të ardhur nga struktura të ndryshme, nga bota akademike, ILDKPI e të tjera me radhë, qëndrojnë në të tria fazat.

Punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës apo të SHÇBA-së, që kalojnë vettingun në fazën e parë, një pjesë e tyre shndërrohen në komisionerë në fazën e dytë, pastaj zhvillohet faza e dytë, e cila kryesisht merret me nivelin e drejtorive dhe të shëfave të sektorëve nga drejtoritë e qendrës dhe në bazë. Në fazën e tretë komisionit të këtij niveli të dytë i shtohen të tjerë që kanë kaluar vettingun nga Policia, nga Garda dhe nga SHÇBA-ja dhe formohet struktura e nivelit të tretë, vendore, e cila bën vettingun e pjesës së mbetur të policisë.

Z.Lleshaj theksoi se thelbi është Komisioni i Jashtëm, që qëndron gjatë gjithë kohës, të cilës i shtohen Policia e Shtetit, SHÇBA-ja dhe Garda e Republikës, të cilët kanë kaluar vetë vettingun. Me ndryshimin që bëjmë ngelet po i njëjti Komision i Jashtëm dhe shtohen jo vetëm punonjës nga të gjitha strukturat e Ministrisë së Brendshme, por vetëm nga një strukturë, që është SHÇBA-ja. Nuk është prekur aspak thelbi dhe pavarësia e ligjit ose e vettingut, sepse personat që i bashkohen Komisionit të Jashtëm janë edhe në ligjin e vjetër, edhe në ligjin e ri persona të strukturave të Ministrisë së Brendshme. Pra, në të dyja versionet janë persona të SHÇBA-së, të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës. Në qoftë se ne pretendojmë se është prekur pavarësia e procesit, sepse

personat e fazës së dytë dhe të tretë janë në varësi të ministrit, atëherë edhe me ligjin e mëparshëm kjo pavarësi është prekur, pasi personat që do të bëjnë këtë proces janë në varësi të ministrit, sepse janë ose Policia e Shtetit, ose Garda e Republikës, ose SHÇBA-ja dhe kjo bie.

Duhet ta kemi parasysh dhe vlen për ta përmendur se Ministria e Brendshme është një institucion i rëndësishëm kushtetues i vendit, i cili ka përgjegjësi shumë herë më të madhe dhe shumë herë më të rëndësishme sesa menaxhimi i një procesi të vettingut.

Standardi nuk është prekur në mënyrë kategorike. Kjo për arsyen se do të jenë po të njëjtat struktura që do të bëjnë procesin. Pse e kemi bërë këtë ndryshim?! Sepse sistemi i vjetër do të na kërkojë që në fazën e tretë ne të kemi 270 persona, kryesisht të niveleve të larta drejtuese, të cilët shikëputen nga detyra e tyre dhe do të bëjnë vettingun për pjesën e mbetur, por të heqësh 270 funksione të larta drejtuese nga Policia e Shtetit dhe ta dedikosh këtë kategori drejtuesish për vettingun, do të thotë të bësh një ndërhyrje të thellë në funksionalitetin e vetë policisë, e cila duhet të merret me punë të tjera. Ndërkohë ne themi që, meqenëse Ministria e Brendshme ka një strukturë të dedikuar për vettingun, që është SHÇBA-ja, në fazën e dytë dhe të tretë SHÇBA-ja të angazhohet plotësisht dhe të bëjë detyrën që i takon me ligj, sepse SHÇBA-ja është një strukturë vettingu, e cila është krijuar për vetting dhe do të ekzistojë për të bërë vetëm vettingun. Është krijuar një lloj iluzioni sikur çfarë po ndodh me vettingun, që ne tashmë e quajmë proces të vlerësimit kalimtar. Është më rëndësi të themi se vettingu është një proces që nuk mbaron kurrë, sepse, nëse ne pretendojmë që e bëjmë vettingun sot, i kaluam njerëzit, ditën e nesërme rreziku i komprometimit të personit është aty dhe dikush që ka kaluar një herë vettingun nesër mund të komprometohet. Nuk duhet të harrojmë se çdo hyrje në Policinë e Shtetit i nënshtrohet një procedure vettingu, që e bën SHÇBA-ja. Kjo do të thotë se procesi është i pandërprerë, pavarësisht se ky ligj është kalimtar dhe struktura që ka për mision ligjor ta bëjë vettingun e pandërprerë është SHÇBA-ja, e cila do ta bëjë përherë.

Në këtë kuptim, pretendimi se SHÇBA-ja komprometon procesin është përtej absurdit. Kjo për arsyen se paragjykohet struktura, e cila ka detyrë të bëjë vettingun e përhershëm të Policisë së Shtetit sot, nesër e përherë. Në qoftë se kemi pretendim ose paragjykim që SHÇBA-ja është një strukturë që nuk bën dot vettingun, atëherë duhet të atakojmë ligjin e SHÇBA-së dhe të themi se vettingun do ta zgjidhim në një mënyrë tjetër, i cili është proces i përhershëm.

Mandej Z.Lleshaj, lidhur me bindjen presidenciale, e cila është shprehur dhe ka krijuar bindjen se, në qoftë se procesi është nën varësinë e Ministrisë së Brendshme, do të komprometohet politikisht dhe do të keqpërdoret politikisht, u shpreh se kjo mënyrë argumentimi duhet të ketë shumë vëmendje, sepse nuk mund të lejohet të paragjykohet nga askush, qoftë edhe nga Presidenti, një institucion kushtetues, siç është Ministria e Brendshme.

Ministria e Brendshme ka përgjegjësinë kushtetuese që të mbajë, të drejtojë dhe të udhëheqë veprimtarinë e të gjitha organeve që ka në varësi të saj, të Policisë së Shtetit,

Gardës së Republikës, SHÇBA-së, strukturave të tjera e me rradhë, të cilat janë nën varësi të Ministrisë së Brendshme pikërisht për t'u drejtuar politikisht, jo në kuptimin partiak, por në kuptimin e politikës shtetërore. Është krejtësisht e papranueshme që të pretendosh se kemi një paragjykim dhe një paranojë nga një institucion kushtetues që është Ministria e Brendshme. Sigurisht që Ministria e Brendshme bën drejtimin politik dhe udhëheqjen politike të të gjitha këtyre strukturave. Këtë e kërkojnë Kushtetuta dhe i gjithë sistemi politik që kemi sot në fuqi. Nuk mund të paramendohet që të krijohen struktura jokushtetuese, duke u nisur nga paragjykimi që ministrinë nuk e bëjnë punën, kështu që do të shpikim instrumente të tjera jashtë Kushtetutës, me atë ndajshtimin "të pavarur", që të na bëjnë një proces objektiv. Në thelb, ne duhet të rrimë brenda linjës kushtetuese, e cila parashikon institucionet si struktura përgjegjëse për të realizuar një proces të pavarur.

Për sa u përket pretendimeve për pavarësinë e procesit, Z.Lleshaj u shpreh se duhet të kemi parasysh se kjo pavarësi jepet nga ligji dhe nuk varet nga strukturat. Ligji u ka dhënë status të pavarur të gjithë personave që përfshihen në procesin e vetingut, ashtu sikur u jep garancinë përkatëse që ky proces të zhvillohet në kushtet e integritetit dhe pavarësisë së plotë. Pra, nuk mund t'i pranojmë në mënyrë kategorike argumentet që drejtimi i procesit nga Ministria e Brendshme rrezikon vetë procesin. Jo, është e kundërta, pra do të ishte problem në qoftë se kërkojmë procese, të cilat janë jashtë institucioneve. Proceset janë të besueshme atëherë kur zhvillohen nga institucionet, të cilat kanë përgjegjësi kushtetuese për t'i kryer ato.

Ndërsa në lidhje me pretendimin e Presidentit se nëse do t'i japim më shumë kohë procesit, i vëmë nën presion njerëzit që janë në proces vetingu., Z.Lleshaj argumentoi se vettingu është një proces që do të vazhdojë edhe kur të mbarojë ky ligj.

Kështu që, nëse ne kemi njerëz që do të jenë apo ndihen nën presion prej vetingut, shumë mirë, le të ndihet nën presion kushdo që ka arsye për t'u ndier nën presion. Ky presion do të vazhdojë përherë mbi Policinë e Shtetit, mbi Gardën e Republikës, mbi vetë SHÇBA-në. Kushdo duhet të ndihet nën presion, nëse ka një problem që lidhet me vetingun. Nuk është argument "që të kemi një afat, sepse nga ajo ditë e tutje njerëzit të çlirohen". Njerëzit nuk kanë arsye pse të çlirohen, ata që nuk kanë ndonjë mizë nën kësulë. Të tjerët janë të çliruar edhe sot. Shumica absolute e Policisë së Shtetit nuk janë as sot nën presion nga vetingu, sepse nuk presin të ndodhë asgjë nga vetingu, sepse ata janë njerëz që kryejnë me devocion, integritet e profesionalizëm punën e tyre dhe vetingun e konsiderojnë si një proces teknik, në të cilin do të hyjnë, do të dalin, do të certifikohen dhe do të vijojnë më tej punën pa asnjë problem.

Në përfundim, Z.Lleshaj ftoi anëtarët e komisionit që t'i qëndrojnë vendimit të mëparshëm për ta lënë në fuqi ligjin dhe për ta rrëzuar dekretin e Presidentit, për arsye se nëpërmjet këtij ligji jemi të sigurt që i japim një ritëm të ri procesit.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenin 29/2 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit , caktoi në cilësinë e relatorit për këtë çështje, z.Pjerin Ndreu.

Më së pari, Kryetarja e Komisionit Z.Ermonela Felaj, kërkoi të saktësojë dy çështje procedurale dhe konkretisht:

- Për procedurën parlamentare, më të cilën ka kaluar ligji nr.20/2019, ai sqaroi se Kuvendi i Shqipërisë ka proceduar në mbështetje të plotë të nenit 83 të Kushtetutës dhe nenit 28 të Rregullores së Kuvendit, ku përcaktohet respektivisht si më poshtë:

Neni 83

- 1. Projektligji votohet tri herë: në parim, nën për nen dhe në tërësi.*
- 2. Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit.*
- 3. Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81 paragrafi 2, me përjashtim të nënparagrafit dh.*

Neni 28

Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve

- 1. Me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një të pestës së të gjithë numrit të deputetëve, Kuvendi mund të shqyrtojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar.*
- 2. Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81 pika 2 të Kushtetutës, me përjashtim të shkronjës “dh”.*
- 3. Kërkesa për procedurë të përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjit paraqitet me shkrim te Kryetari i Kuvendit, i cili ia njofton Kuvendit në seancën plenare më të parë. Pas njoftimit të Kryetarit dëgjohet një folës pro dhe një folës kundër për jo më shumë se 10 minuta. Kryetari i Kuvendit i paraqet Kuvendit për votim projektvendimin përkatës, në të cilin përcaktohet data e shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës, afati brenda të cilit mund të propozohen amendamente dhe data e shqyrtimit në seancë plenare. Konferenca e Kryetarëve mund të përcaktojë kohën e debatit në seancë plenare, duke respektuar rregullin e parashikuar në nenin 48 pika 3 të kësaj Rregulloreje.*
- 4. Afati, brenda të cilit duhet të shqyrtohet çështja në komision dhe në seancë plenare, nuk mund të jetë më pak se një javë nga data e paraqitjes së kërkesës nga Kryetari i Kuvendit në seancë plenare.*
- 5. Kuvendi nuk mund të shqyrtojë më shumë se tri projektligje me procedurë të përshpejtuar për programin 12-javor të punës së Kuvendit dhe një projektligj për programin 3-javor të punës së tij.*

Ky ligj nuk është një ligj që miratohet me shumicë të cilësuar dhe si i tillë mund t'i nënshtrohet edhe procedurës së përshpejtuar e cila në thelb nuk ka të bëjë më kohën që marrin diskutimet e projektligjit në komisionet parlamentare përkatës, por lidhet vetëm me afatin e qëndrimit të projektligjit në Kuvend nga momenti i depozitimit të tij nga Këshilli i Ministrave deri në momentin e shqyrtimit nga komisionet parlamentare.

- Lidhur me procesin e konsultimit publik të ndryshimeve të propozuara në ligj, Znj.Felaj u shpreh se vetë ligji që ndryshohet është konsultuar gjerësisht me organizatat që asistojnë Policinë e Shtetit, si PAMECA dhe ICITAP dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë.

Ndryshimet e propozuar më pas në ligj nuk e shfuqizojnë dhe as zhbëjnë thelbin e ligjit, por vetëm thjeshtojnë mekanizmin e ushtrimit të vettingut ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, është kujdesur që gjatë diskutimeve të ndryshimeve të ligjit, të ftojë edhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit sepse grupi i interesit në këtë rast është Policia e Shtetit, është ajo që impaktohet direkt nga ligji dhe nuk janë komisionet që do bëjnë vettingun.

Pas këtyre dy saktësimeve, fjalën e mori Z.Ndreu, i cili u shpreh se argumentet e Presidentit, janë paragjykim të cilat ngjajnë më shumë si argumente politike sesa teknike. Në qoftë se hyjmë në argumentet teknike, situata nuk përputhet askund me argumentet që sjell dekreti i Presidentit të Republikës. Të paragjykos ministrit dhe ta lidhësh me SHÇBA-në dhe me një rol, i cili në argumente jepet si rol negativ, sepse e nxjerr SHÇBA-në si instrument në dorën e ministrit që po kryhen një punë antiligjore, është e gabuar.

SHÇBA-ja është një strukturë shumë serioze që ka detyra funksionale të përcaktuara. Detyrat e SHÇBA-së nuk janë detyra që vijnë me urdhra ministri, por janë detyra funksionale të mirëpërcaktuara. SHÇBA-ja ka detyrë funksionale periodike që të marrë informacion, të bëjë analizat e informacionit, të gjejë fakte dhe prova për çdo punonjës policie, i cili në kryerjen e detyrës konsumon vepra penale apo veprime të tjera antiligjore, që çenojnë dinjitetin e punonjësve të policisë. Është detyrë funksionale periodike. Madje, po ta shohim në konceptin e vettingut, kjo është struktura që ka kredencialet më të larta dhe përgatitjen profesionale më të lartë në këtë drejtim. Çdolloj struktura tjetër nuk ka përvojën apo kredencialet e kësaj strukture.

Në lidhje me pretendimin e Presidentit se SHÇBA-ja ka varësinë politike, nga Ministri I brendshëm Z.Ndreu shtoi se, Komisioni i Jashtëm përbëhet nga njerëz që nuk janë në vartësi të ministrit, ndërsa komisioni qendror dhe ai vendor, përbëhen nga punonjës policie. Po ta shikojmë në pikëpamjen e rrezikut të ndikimit politik, ka më shumë peshë rreziku të këta punonjës policie sesa te. Atëherë, si mund ta përdorim këtë argument?! Nëse e përdorim atë argument, do të bëjmë vetëm diferencën: ku ndryshoi ligji që ishte me këtë që është dhe pse këta qenkan në varësi të ministrit dhe paskan rrezik, ndërkohë ata që ishin përsëri në varësi të ministrit nuk paskan rrezik? Pra, ky argument nuk qëndron dhe, siç e thashë, i ngjan më shumë argumentit politik sesa atij teknik, që do të paragjykojë një ministër, një qeveri, se ne po ndërhyjmë te një proces, të cilit nuk e kuptoj pse duhet t'i jepet gjithnjë konotacion negativ.

Mandej Z.Ndreu, në lidhje me afatin e procesit u shpreh se koha është përcaktuar në bazë të një analize. Pra, është bërë një analizë dhe përderisa është bërë një analizë, kjo e fundit tregon se koha është e pamjaftueshme.

Në fakt, ka edhe një problem tjetër, që lidhet me detyrat funksionale të atyre oficerëve të lartë të policisë, që do të marrin pjesë si anëtarë të komisioneve qendrore dhe vendore, që lidhen me ligjin e vjetër. Por në qoftë se ne e shtrëngojmë në kohë dhe i detyrojmë ata që të punojnë me kapacitete mbi normativë, ata do të cedojnë në detyrat funksionale që kryejnë gjatë ditës ç'ka çënon realisht cilësinë e punës në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë, për të cilat ne kemi shumë nevojë.

Implikimi i tyre, nëse do ta shtrëngojmë brenda një harku kohor, që ishte në detyrat e vettingut, është një punë suplementare, që nuk i takon si detyrë funksionale, por i ngarkon dhe u ha edhe kohën fizike, që u duhet të punojnë me ata, të paktën sipas opinionit tim. Pra, koha është bërë me analizë dhe zgjatja e kohës nuk ka lidhje me historinë apo argumentin e presidentit, që thotë: “do t’u zgjatet koha disa personave që”...

Unë jam dakord që procesi i vettingut është i vazhdueshëm, pra një proces që nuk ka kohë, edhe SHÇBA-ja pikërisht për këtë, sepse është një strukturë, që e ka detyrë permanente dhe nuk pushon së qeni me afat. Nuk ka sesi të pushojë së qeni me afat.

Duhet të shikojmë edhe fizionominë e institucionit. Nuk mund ta marrim për analogji atë që ndodh në drejtësi me atë që ndodh në polici. Struktura e policisë nuk është si struktura e drejtësisë, duhet ta kuptojmë, është një strukturë më dinamike, është një strukturë që lëviz. Pra, struktura e drejtësisë është më e konsoliduar në pikëpamjen e burimeve njerëzore dhe qëndrimit në kohëzgjatje në punë, ndërsa strukturat e policisë janë tjetër gjë.

Në rastin konkret është vullneti për të shkuar në një proces vettingu. Instrumentet, të cilët janë gjetur për ta çuar vettingun përpara na garantojnë se procesi kryhet dhe ky është thelbi i procesit ne nuk kemi ndryshuar asgjë.

Për sa më sipër, Z.Ndreu kërkoj të rrëzohet dekreti i Presidentit, si i paargumentuar teknikisht.

Më pas anëtarët e komisionit diskutuan bashkarisht dhe shprehen opinionet e tyre mbi argumentet e kthimit të ligjit për rishqyrtim ku konkretisht:

- **Së pari**, lidhur me pretendimin se ndryshimet në strukturë që i bëhen procesit të vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave, çënojnë standarte e vendosura, objektivitetin, pavarësinë dhe paanshmërinë e procesit të vlerësimit, **ky pretendim nuk qëndron për arsyt e mëposhtme:**

Sipas ligjit nr. 12/2018, miratuar një vit më parë, procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave, do të realizohej në 3 faza :

- **Faza e parë** e vlerësimit, do të kryhej nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, që do të vlerësonte punonjësit që mbajnë grada apo funksione të larta në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Sipas analizës paraprake të propozuesve të ligjit, ky komision do të vlerësonte gjithsej 287 punonjës;
- **Faza e dytë** e vlerësimit, do të kryhej nga Komisioni Qendror i Vlerësimit dhe kjo përfshinte vlerësimin e 2700 punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit dhe 115 punonjësve të Gardës së Republikës, që mbajnë grada të nivelit të mesëm drejtues.

Komisioni Qendror i Vlerësimit do të përbëhej nga 45 anëtarë, 15 prej të cilëve do të ishin anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, ndërsa 30 anëtarët e tjerë do të përzgjidheshin nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, me procedurë të hapur konkurrimi, ndërmjet punonjësve me grada të larta të dalë me sukses nga vetimi në fazën e parë.

- **Faza e tretë** e vlerësimit do të kryhej nga Komisioni Vendor i Vlerësimit, i cili do të vlerësonte 9000 punonjës të Policisë së Shtetit pranë strukturave vendore të Policisë së Shtetit dhe punonjësit e Gardës së Republikës, me përjashtim të punonjësve që vlerësohen nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Komisioni Qendror i Vlerësimit.

Komisioni Vendor i Vlerësimit do të përbëhej nga 135 anëtarë, 45 prej të cilëve anëtarë të Komisionit Qendror të Vlerësimit, ndërsa 90 anëtarët e tjerë do të përzgjidheshin nga radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, nga Komisioni Qendror i Vlerësimit, me procedurë të hapur konkurrimi, të vetuar rregullisht në fazën e dytë.

Me ligjin nr.20/2019, faza e parë e vlerësimit do të mbetet e pandryshuar, pra vlerësimi i punonjësve të policisë që mbajnë grada të larta, do të kryhet nga Komisioni i Jashtëm i përbërë prej 15 anëtarësh dhe një staf teknik prej 15 personash.

Komisioni i Jashtëm ndërkohë është konstituar dhe kjo ka shënuar praktikisht fillimin e procesit zyrtar të vettingut dhe pritjet që në një kohë të shkurtër të fillojë dhe të hapen dhe dosjet e para të drejtuesve të lartë të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës, me qëllim që rezultatet e para të procesit të jenë të prekshme në një kohë shumë të shkurtër.

Ndërsa vlerësimi në fazën e dytë dhe të tretë (që do të bëhej respektivisht nga Komisioni Qendror dhe Vendor i Vlerësimit), do të kryhet nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme (në vijim Shçba), e cila

paraprakisht do të kalojë procesin e vettingut në fazën e parë, kjo me qëllim që SHÇBA-ja të shndërrohet në aktorin kryesor të procesit për më tej, ashtu sikundër e parashikon dhe ligji organik i saj, si strukturë e cila ka për detyrë të kujdeset që Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës, të jenë struktura të pastra, me integritet dhe të angazhuara vetëm në shërbim të ligjit dhe në asnjë lloj shërbimi tjetër.

Ne besojmë fort që këto ndryshime kanë disa avantazhe, përveç faktit që e sjellin në kohë të gjithë procesin, ato kanë dhe një impakt të rëndësishëm sië më poshtë do të shtjellojmë.

Nga ana tjetër, duam të theksojmë se procesi garanton pavarësi, paanshmëri pasi ai nuk ndryshon as kriteret apo procedurat e vlerësimit. Dhe ky është pohimi themelor që duhet të kemi parasysh, që me gjithë ndryshimet e karakterit teknik dhe administrativ, thelbi i procesit mbetet i paprekur, pra kriteret dhe procedurat e vlerësimit mbeten ekzaktësisht të njëjtat.

Bindja e krijuar nga Presidenti i Republikës *se ky proces ka ndikim politik dhe se qëllimi kryesor i ndryshimit të propozuar lidhet vetëm me synimin për të kontrolluar procesin nëpërmjet Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (në vijim SHÇBA), strukture varësie e Ministrisë së Brendshme*, është jo e bazuar .

Ndryshimet e propozuara nuk prekin aspak thelbin e procesi të Vettingut, përkundrazi, i gjithë ndryshimi bëhet në shërbim të një procesi më të shpejtë dhe më efektiv.

Ligji nr.70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” përcakton se SHÇBA është një strukturë në varësi të Ministrisë të Brendshme, por ligji në fjalë duhet parë mbi të gjitha për frymën që përcjell ose kërkoi të përcjellë që në momentin që u propozua dhe u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë.

Misioni i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, është garantimi i zbatimit të ligjit, mbrojtja e interesave të ligjshëm të shtetit si dhe të drejtave të shtetasve, nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të punonjësve të strukturave, pavarësisht nga funksioni dhe grada.

Objekt i veprimtarisë së Shërbimit janë:

- a) parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale, si dhe i shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj;
- b) inspektimi dhe trajtimi i ankesave ndaj punonjësve të strukturave për mospërbushje të detyrës, sipas standardeve të miratuara me akte normative, për vepra penale dhe shkelje të tjera të ligjit;
- c) ruajtja e integritetit të punonjësve të strukturave;
- ç) verifikimi i pasurisë së punonjësve të veçantë të strukturave, ndaj të cilëve referohen ankesa dhe kallëzime;
- d) analiza, studime dhe rekomandime të përgjithësuara në bazë të inspektimeve dhe hetimeve për aspekte të rëndësishme të organizimit e të funksionimit të strukturave dhe pritshmërisë së publikut në drejtim të sigurisë publike.

Parimet bazë mbi të cilat organizohet dhe funksionon Shërbimi, janë:

- a) ligjshmëria;
- b) pavarësia nga strukturat, ndaj të cilave ushtron veprimtarinë e tij;
- c) paanshmëria;
- ç) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- d) respektimi i dinjitetit dhe integritetit fizik;
- dh) transparenca;
- e) proporcionaliteti;
- ë) ruajtja e informacionit të klasifikuar;
- f) kontrolli dhe llogaridhëni

Përdorimi i SHÇBA-së si strukturë e cila do të bëjë vettingun për fazën e dytë dhe të tretë, pra për trupën e nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues, do të thotë që të ruhet i njëjti standard vlerësimi, por mbi të gjitha të shkurtohet koha për arsye se SHÇBA-ja, duke qenë se është vetë aktori i këtij procesi, do të ketë në dispozicion, të gjithë të dhënat dhe informacionet e nevojshme mbi bazën e të cilave kryhet vettingu. Dhe në këtë mënyrë shkurtojmë një hallkë të ndërmjetme, sepse SHÇBA-ja, sikur parashikohej para ndryshimeve të propozuara, do ta pasonte informacionin te Komisioni i Vlerësimit dhe ky i fundit do të bënte mandej vlerësimin e figurës së punonjësit mbi të dhënat e Shërbimit.

Mos harrojmë po ashtu që Komisionet Qendrore dhe Vendore të Vlerësimit, do të ishin në shumicë komisione të përbëra nga anatarë të vetuar nga brenda policisë, sepse i gjithë kompozimi i trupës që veton është propozuar sipas sistemit kaskadë sikundër u parashtrua më lart.

Pra argumenti se vetimi sipas ndryshimeve të propozuara, do të bëhet nga punonjës që janë varësi e Ministrisë dhe për rrjedhojë procesi do të jetë politik ose do të lejojë ndërhyrje të ngjashme, është krejtësisht i rrezueshëm, nga momenti që dhe sipas ligjit në fuqi të vettingut, të dekretuar menjëherë nga Presidenti i Republikës, vetimi për pjesën më të madhe të punonjësve të policisë do të kryhej nga po ata vetë, për të zvogëluar kostot dhe për të garantuar besimin e mos keqpërdorimit të procesit .

Shërbimi është një strukturë e krijuar me ligj, që ka ekzistuar si e tillë dhe me parë ligjit aktual të tij, dhe si i tillë ai ka krijuar përvojën e nevojshme dhe të domosdoshme, për të ushtruar detyrën sipas parimeve që ia imponon ligji bazë, ku vlen të veçohen pavarësia nga strukturat ndaj të cilave ushtron veprimtarinë e tij dhe paanshmëria.

Komisioni Qëndror dhe Vendor i Vlerësimit janë dy organe që nuk janë krijuar ende dhe dhe pikërisht për shkakun se ato nuk ekzistojnë, formalisht nuk mund të flitet për shkrirje apo abrogim organesh.

Ndryshimet e propozuara kërkojnë të thjeshtojnë mekanizmin e ushtrimit të vetimit duke u kujdesur që nisja e procesit të jetë e njëjta e propozuar edhe më parë.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare u ndal më pas tek çështja e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore që kërkon ky proces.

Ata u shprehën se është e vërtetë që Këshilli i Ministrave me miratimin e ligjit 12/2018 i garantonte Kuvendit sigurimin e efekteve financiare që sillte ligji e që lidhen me trajtimin financiar të antarëve të organeve të vlerësimit kalimtar, të sekretarive teknike përkatëse dhe burimeve të tjera njerëzore që do të angazhoheshin ekstra në këtë proces, por në vijim u verifikuan disa rrethana objektive, të tilla që cuan në rishikimin e qëndrimit dhe për këtë pjesë që gjithsesi është e rëndësishme sepse garanton zbatimin e procesit në vetvete.

Kërkohej që rreth 240 punonjës me kohë të plotë nga strukturat e Policisë dhe të SHÇBA-së, të shpërbëhen nga funksioni i tyre bazë dhe t'i dedikohen vettingut me kohë të plotë; pra ky është një volum i madh pune dhe këtij volumi i bashkëshoqërohet dhe një faturë jo e vogël financiare, e cila shkon rreth 3 milionë dollarë, kosto e parashikuar e këtij procesi.

Sjellim në vëmendjen e Presidentit të Republikës se që me konstituimin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, ky i fundit i është drejtuar disa herë këtij komisioni parlamentar, me kërkesën për të riparë të drejtat e njohura atyre.

Ndonëse ligji nuk i prashikon si organ i pavarur, është kërkuar që ata të kenë të njëjtën status me antarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, KPK dhe Kolegjit të Apelit, në sistemin e drejtësisë, kërkesë kjo tërësisht e pavend.

Organet e vettingut si më sipër, janë organe kushtetuese, të parashikuara shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që të ashtuquajtura komisione të vlerësimit, asnjherë dhe për asnjë moment nuk janë menduar apo propozuar që të konfiguroheshin si të tilla si nga propozues fillestar i ligjit, Këshilli i Ministrave dhe mandej ligjvënësi.

Është e qartë se në rastin e nevojës së propozuar me ligj për vetimin e punonjësve të policisë së shtetit, është marrë ideja e vetimit, ku konsiston vetimi në tërësi, por jo mekanizmi, i cili ndonëse do të funksionojë për aq sa është e mundur sipas të njëjtave kritere vlerësimi, nuk është identik me atë të parashikuar për të vepruar ndaj antarëve të sistemit të drejtësisë.

Pra siç e shikoni, qasja e antarëve që përbëjnë komisionin e jashtëm dhe tendenca e tyre e përshkruar më lart, ka qenë për t'i rritur shpenzimet dhe për t'u rikonfiguruar si trupë.

Ky qëndrimi i tyre në raport me detyren, sipas kushteve të shfaqura, ka penguar realisht fillimin e zbatimit të ligjit, sikundër potencialisht ka rritur ose tentoi të rrisë dhe financat e planifikuara për zbatimin e procesit të vettingut.

Detyra jonë është të garantojmë procesin e vettingut dhe ky proces me ndryshimet e propozuara garantohet si në pikëpamje të funksionimit të rregullt, ashtu dhe të mbështetjes së duhur dhe të arsyeshme financiare .

Pra, me ndryshimet që ne kemi miratuar unanimisht në këtë komision, si komisioni përgjegjes, mund të themi se e kemi garantuar më së miri kryerjen e vettingut në radhët e punonjësve të policisë së shtetit.

Komisioni bëri një analogji edhe me ligjin për buxhetin e shteti, duke theksuar se dhe ky ligj po ashtu rishikohet disa herë brenda vitit, pikërisht për t'iu përshtatur mbledhjes reale të të ardhurave dhe shpenzimeve publike.

Në çdo rast të ngjashëm, do të kishim dakortësinë që me një financim të arsyeshëm të arrihej qëllimi i zbatimit të ligjit dhe ndërkohë të ruhej balanca e financave të shtetit.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka qënë shumë i kujdesshëm edhe në këtë pikë, për faktin e thjeshtë se me Policinë e Shtetit në vçcanti, nuk sheh të lidhur vetëm një nevojë , por disa të tilla, që kanë prioritet të ndryshëm mes njëra tjetrës dhe të tjera nevoja që ka shteti.

Vettingu ka rëndësinë e vet, por zbatimi i këtij procesi dhe kostot e tij, nuk mund të çënojnë a të disbalancojnë, kostot e luftës kundër krimit, të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, që janë detyra kryesore të Policisë së Shtetit dhe të pandara.

Sa kohë krimi sofistikohet, është detyra jonë dhe përgjegjesia jonë si të zgjedhur a si shtetarë, që të mbështesim policinë sa më mirë financiarisht, në mjete, paisje, pajime, teknologji, infrastrukturë, kapacitete njerëzore gjithashtu, gjë e cila ndonëse është bërë në vijësi nga Qeveria, sa kohë në të paktën dy vitet e fundit buxheti i akorduar Ministrisë së Brendshme ka ardhur duke u rritur dhe ka qënë më i madhi në dekadën e fundit, ende ngelet shumë për të bërë dhe për të përmirësuar në të gjithë trupën.

Komisioni i Sigurisë në të gjitha komunikimet me Ministrinë e Brendshme ka kërkuar që fondet e Qeverisë të fokusohen te nevojat prioritare me imediate dhe këtu mund të bëjmë një matematikë shumë të thjeshtë; me po atë shumë të hollash që kërkon procesi i vettingut , mund të ishin bërë disa salla operative me kamera (një sallë kushton vetëm 80 mijë euro dhe aktualisht ka vetem Drejtoria e Tiranës) në Drejtoritë e Policisë më të mëdha në vend dhe të ishin pajisur me kamera trupi dhe shumë efektivë të tjerë, çka janë një ndihmë e jashtëzakonshme për punën e Policisë së Shtetit.

- *Së dyti lidhur me pretendimin se ligji eliminon detyrimin ligjor për të përfunduar procesin e vlerësimit brenda një afati të caktuar, duke krijuar mundësinë e zgjatjes së tij pa afat, sqarojmë se:*

anëtarët e komisionit u shprehën se janë shumë dakort që procesi duhet të ketë një afat dhe pikërisht për këtë, ne si komision përgjegjës, jemi kujdesur që të kemi një siguri më

shumë duke vendosur një afat që nuk ishte më parë në ligj dhe ky afat ka të bëjë me punën e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, do të vlerësojë punonjësit që mbajnë grada apo funksione të larta në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat brenda një afati një vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit, afat që nuk ishte caktuar më parë.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka qënë i vëmendshëm për ewshtjen e afatit, pasi procesi patjetër që duhet të ketë afate brenda të cilit duhet të zhvillohet, por mos harrojmë që afatet janë veçanërisht të rëndësishme për pjesën thelbësore që i nënshtrohet vettingut, gradat e larta dhe ato drejtuese që i japin tonin gjithë punës në policinë e shtetit e që në anë tjetër kanë dhe premisën më të lartë apo presionin më të lartë për t'u joshur nga krimi.

Ne kemi vendosur që ky komision duhet të përmbushi punën e tij **brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit dhe jo me kot**, pasi është shumë e rëndësishme që gradat e larta, për të cilat është e mundur kontrolli në tërë parametrat (figurën, integritetin dhe pasurine) procesi i vettingut të tyre, të përfundojë brenda një kohe të arsyeshme.

Kujtojmë që pjesa më e madhe e punonjësve të Policisë së Shtetit, nuk janë subjekte dhe as nuk ka qënë subjekte te deklarimit të pasurisë dhe kontrollit të interesave. Ata është dashur të deklarojnë rishtas për pasurinë për shkak të ligjit të vettingut . Rrjedhimisht, e gjithë kjo sjell një ngarkesë në kontrollin dhe justifikimin e ligjshëm të pasurisë, së pjesës më të madhe të punonjësve të policisë shtetit, sikurse kërkon dhe një kujdes më të shtuar dhe një afat kohor të vështirë për t'u përcaktuar, por ju për t'u ndjekur dhe monituaruar, nga organi i cili do të vetojë.

Afati 24 muhor, i vendosur me ligjin 12/2018, brenda të cilit duhet të përfundonte i gjithë procesi i vettingut, u hoq si një afat jo objektiv, sikurse dhe për faktin që ligji filloi të implementohej me 1 vit vonesë.

Të dhënat e vettingut të prokurorëve dhe gjyqtarëve, ndihmojnë po ashtu për të kuptuar vështirësinë e konkludimit të një afati final, në kushtet kur trupa e policisë së shtetit që do të vetohet nga Shërbimi, është disafish më e madhe në numër, sesa gjithë trupa e gjyqtarëve dhe prokurorëve, këshilltarëve ligjorë etj.

Në sistemin e drejtësisë janë rreth 800 persona që do t'i nënshtrohen procesit të vettingut, 111 persona e kanë kaluar tashmë këtë proces, ndërsa punonjës policie që do të duhet të vetohen nga Shërbimi do të jenë mbi 12 mijë vetë.

Nga ana tjetër, ne si komision parlamentar, kemi pasur parasysh evitimin e ndërhyrjeve të shpeshta në ligj, pasi në praktikën parlamentare është treguar që afatet shpeshherë nuk janë respektuar dhe është dashur që në ligje të ndryshme të ndërhyhet vetëm për çështje

të zgjatjes së afateve, gjë e cila nuk duket aspak korrekte, impenjimi i parlamentit vetëm në çështje të kësaj natyre.

Kuvendi i Shqipërisë duke vendosur në ligj, mbi të gjitha me konsensus, krijimin e Nënkomisionit për Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të Vetingut, me përbërje të mazhorancës dhe opozitës, **ka ofruar një garanci të qartë dhe të mjaftueshme që vetimi i gjithë trupës së Policisë së Shtetit nga Shërbimi, të ushtrohet brenda afateve të arsyshme, përtej çdo keqpërdorimi dhe ndikimi të paligjshëm, duke shmatur kështu çdo lloj dyshimi se mungesa e një afati konkret për rastin në fjalë, do të çojë në mënim nga qëllimi i pandryshuar i ligjit të cilin po diskutojmë.**

- *Përfundime*

Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, votoi pro rrëzimit të Dekretit të Presidentit nr.11175, datë 19.04.2019 dhe kalimin e tij seancës plenare në përputhje me nenin 85/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Relator

Pjerin NDREU

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ